



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 66, datë 19.04.2021

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I GRANTIT TË RINDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 172, datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”, të ndryshuar, vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar, urdhrin nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit të Komisionit të Posaçëm me nr. 15666 prot., datë 14.04.2021, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga programi i grantit të rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Subjektet përfituese të përcaktuara në pikën 2, përfitojnë vlerat e grantit të rindërtimit të parashikuara në vendimin nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale njofton menjëherë njësitë administrative/lagjet për nënshkrimin e kontratës së grantit të rindërtimit.
5. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të këshillit bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga programet e rindërtimit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.

7. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO